



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA VLORË  
DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE

Nr. 16363 prot.

Vlorë, më 21.12 2022

PROJEKT -VENDIM

Nr. \_\_\_\_\_ , datë \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 2022

PËR

**MIRATIMIN E VLERËS FINANCIARE TË DËMEVE TË SHKAKTUARA NGA  
DJEGJA E BANESËS TË Z. GAZMIR KUÇAJ NË DATËN 21.10.2022, DHE  
SHPËRBLIMIN FINANCIAR NGA ANA E BASHKISË VLORË.**

Këshilli i Bashkisë Vlorë në zbatim të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 8 pika 2, neni 9/1 pika b, neni 29/1, neni 54 pika dh ,të ligjit nr.45/2019 datë 18.07.2019 “Për mbrojtjen civile”,në VKM Nr. 329 data 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore” paragrafi III/ë dhe pika 3/a, pasi mori në shqyrtim materialin e përgatitur nga Drejtoria e Mbrojtjes Civile, Drejtoria e Financës dhe Këshilli i Qarkut Vlorë,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë vlerën financiare të dëmeve të shkaktuara nga diegia në banesën e z.Gazmir Kuçaj, e ndodhur në lagjen “Partizani”,Rruga “Ali Demi”, Rajoni Nr 1 Bashkia Vlorë, në datën 21.10.2022 ,sipas preventivit të hartuar nga ekspertët e Këshillit të Qarkut Vlorë përkatësisht në masën:

- 153.829 (njëqind e pesëdhjetë e tre mijë e tetëqind e njëzet e nëntë) lekë për punime ndërtimi. (307,658x50% )
- 551.077(pesëqind e pesëdhjetë e një mijë e shtatëdhjetë e shtatë) lekë për mobilje dhe pajisje elektroshtëpiake

2. Shpërblimi financiar do të përballohet nga fondi i kushtëzuar i buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile të Bashkisë Vlorë.

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financë-Buxhetit dhe Drejtoria e Mbrojtjes Civile pranë Bashkisë Vlorë.

4. Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015, neni 55 pika .

**KRYETARI**

**Dritan DELI**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE

Nr. 16363 prot.

Vlorë, më 21.12 2022

RELACION

PËR

**PROJEKT-VENDIMIN “PËR MIRATIMIN E VLERËS FINANCIARE TË DËMEVE TË SHKAKTUARA NGA DJEGIA NË BANESËN E Z.GAZMIR KUÇAJ NË DATËN 21.10.2022 DHE SHPËRBLIMI FINANCIAR NGA ANA E BASHKISË VLORË “**

Në zbatim të VKM Nr. 329 datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, në Bashkinë Vlorë, në datën 21.10.2022 ka paraqitur kërkesën e tij z.Gazmir Kuçaj me Nr.12053 prot, për shkak të djegies së banesës së tij e ndodhur në lagjen "Partizani", Rruga “Ali Demi”, Rajoni Nr 1 Bashkia Vlorë.

Komisioni i Bashkisë Vlorë i ngritur me Urdhërin e Brendshëm Nr. 3 datë 13.01.2022 të Kryetarit të Bashkisë Vlorë, shkoi në banesë për të konstatuar dëmet e shkaktuara nga djegia.

Mbas hartimit të proces verbalit të konstatimit të gjendjes në datë 24.10.2022, është vijuar me shkresën përcjellëse me Nr.12503/1 prot, date 23.11.2022 “Dërgohet dokumentacioni për banesën e djegur të Z.Gazmir Kuçaj”, në Këshillin e Qarkut Vlorë për të vazhduar me preventivat e vlerësimit të dëmeve nga komisioni i ekspertëve.

Këshilli i Qarkut Vlorë me shkresën Nr.1994/3, datë 14.12.2022 “Dërgim preventivi dhe dokumentacioni i banesës së djegur të Z.Gazmir Kuçaj në lagjen "Partizani" Vlorë, ka dërguar preventivin e hartuar nga komisioni i ekspertëve, nga ku rezulton:

1. Vlera e dëmeve në banesën e Z.Gazmir Kuçaj është 704.906 (shtatëqind e katër mijë e nëntëqind e gjashtë) lekë.

Aktualisht Bashkia Vlorë ka mundësi financiare për të ndihmuar familjen për banesën e djegur.

Për sa më lart i kërkojmë Këshillit të Bashkisë të miratojë vlerën financiare të dëmeve të shkaktuara nga djegia në banesën e Z.Gazmir Kuçaj në datën 21.10.2022 sipas preventivit të hartuar nga ekspertët e Këshillit të Qarkut Vlorë dhe shpërblimin financiar i cili do të përballohet nga fondi i Emergjencave Civile i Bashkisë Vlorë.

DREJTORI I MBROJTJES CIVILE

Adrian VRESHTAZI

